



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë **24/02/2021**

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë

Për: Operatorin ekonomik: **RESULI-ER sh.a me NIPT L12510413V**

Adresa: 1. Daullas, Lagjja Mbrostar Ferko, Fier Qendër Fier, rruga "Baltës" banesa nr-53, zona kadastrale nr-3980 numër pasurie nr- 62/24.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-84074-01-14-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje karburant për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: deri më 24 muaj pas nënshkrimit.

Fondi Limit: **61 885 281.6** (gjashtëdhjetë e një milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtë) **Lekë pa TVSH**

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.02.2021 ora 09:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë, këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **RESULI-ER sh.a me NIPT L12510413V**, me adresë: Fier Qendër Fier Daullas Lagjia Mbrostar Ferko, rruga "Baltës" banesa nr-53, zona kadastrale nr-3980 numër pasurie nr- 62/24 me ofertë **26 %** (njëzet e gjashtë) marzhi i fitimit.
2. Operatori ekonomik **BOLV OIL sh.a me NIPT K32528408H**, me adresë: Rruga Fier-Patos, Fshati Grizë, Patos Fier me ofertë **7.6 %** (shtatë pikë gjashtë) marzhi i fitimit.
3. Operatori ekonomik **A&T sh.a NIPT L32320008H**, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", Kulla "Sky Tower", Kati 7, Apartamenti Nr.3, Tiranë me ofertë **23.9 %** (njëzet e tre pikë nëntë) marzhi i fitimit.

SKUALIFIKOHET:

1) Operatori ekonomik **BOLV OIL sh.a me NIPT K32528408H**, për arësyet e mëposhtme:

Nuk plotëson pikën 2.3 pika c) Kapaciteti Teknik pasi operatori ekonomik ofertues **BOLV OIL sh.a me NIPT K32528408H**, rezulton që ka pasur shkelje administrative për Vitin 2020 të konstatuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik, ku janë nxjerrë dhe aktet administrative përkatëse të konstatimit të shkeljes. Operatori ekonomik Bolv-Oil sha e ka ankimuar në Gjykatë aktin administrativ por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që vërteton pezullimin e efekteve të aktit administrativ sipas kërkesë padisë.

2) Operatori ekonomik **A&T sh.a NIPT L32320008H**, për arësyet e mëposhtme:

1. Nuk plotëson pikën 2.3 pika a) Kapaciteti Teknik pasi operatori ekonomik ofertues **A&T sh.a NIPT L32320008H** rezulton që nuk ka paraqitur licencë për tregtimin me shumicë (VIII.1.A për **kategorinë III/C** (Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial)\ ose tregëtimin me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë, për lëndën djegëse sipas objektit të prokurimit, të lëshuar nga organet kompetente por vetëm Licencë Kodi VIII.1.A për **kategorinë III/A** "Tregtim me shumicë i Gazoil kategoria III/A" dhe jo për produktin e kërkuar në DST.

2. Nuk plotëson pikën 2.3 pika b) Kapaciteti Teknik pasi operatori ekonomik ofertues **A&T sh.a NIPT L32320008H** rezulton që nuk ka paraqitur fletë-analizë për produktin e ofruar sipas kërkesave të DST (Gazoil $\leq 0.1\%$), lëshuar nga organi kompetent Inspektoriati Shtetëror Teknik (ISHTI), dhe Industrial, sipas standarteve të përcaktuara dhe në pajtueshmëri me specifikimet teknike të lëshuar jo më parë se muaji Dhjetor 2020. Fletë analiza e paraqitur është lëshuar për produktin Gazoil SSHEN 590:2013/A1:2017 dhe jo për produktin e kërkuar në DST.

3. Nuk plotëson pikën 2.3 pika i) Kapaciteti Teknik pasi operatori ekonomik ofertues **A&T sh.a NIPT L32320008H** rezulton që nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton posedimin në pronësi ose me qira depozita shumice me kapacitet jo më të vogël se 3000 m³ për produktin objekt prokurimi. Referuar dokumentacionit të paraqitur për depozitën "Vërtetim Teknik" lëshuar nga enti certifikues Aproval Swiss Albania Nr.Serial VT1813 datë 28.10.2020, rezulton që kategoria e lejuar për tregtim në këtë depozitë shumice do të jetë "Tregtim me shumicë i Gazoil kategoria III/A" dhe jo për produktin e kërkuar në DST.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik: **RESULI-ER sh.a me NIPT L12510413V**, me seli në adresë: Daullas, Lagjja Mbrostar Ferko, Fier Qender Fier rruga "Baltës" banesa nr-53, zona kadastrale nr-3980 numër pasurie nr- 62/24, me ofertë 26 % (njëzet e gjashtë) marzhi i fitimit, e paraqitur për tenderin me objekt “Blerje karburant për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore”, REF-84074-01-14-2021, me kohëzgjatje deri më 24 muaj nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, me adresë; Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë**, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për lidhjen e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të bëhet anulimi i procedurës sipas të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 16.02.2021

Ankesa: S`ka pasur

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erindi Bejko